

VENDIM
Nr.736, datë 26.10.2011

**PËR ULJEN E TARIFËS SË QIRASË SË MJEDISEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, PËR
ORGANIZIMIN E PANAIRIT XIV TË LIBRIT “TIRANA 2011”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Uljen e tarifës së qirasë së mjediseve të Pallatit të Kongreseve në masën 25 (njëzet e pesë) për qind, për organizimin e panairit XIV, të librit “Tirana 2011”.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha